



Në bazë të nenit 12 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës nr. 03/L-40, nenit 2 dhe 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 569/1 i dt. 16.12.2010, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më 29 shkurt 2016, merr këtë:


V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e Kompanisë NTP, „Vëllezërit Morina“ SHPK për lëshimin **Lejes Mjedisore të Përkohshme për 1 vit**, për shfrytëzimin e ngastrave kadastrale le 777, 778 dhe 779 Flea poseduese Nr. 478, në vendin e quajtur “Rakita vija - rakita” zona kadastrale Xërxe, për prodhimin e betonit dhe separacionit të rërës.
- II. Me qëllim të evitimit të pengesave juridike, zhvillimit të rregullt të procedurës për licencimin pranë institucioneve të Kosovës (KPM, MMPH, MBPZHR) e konsiderojmë si të arsyeshëm që ky propozim të aprovohet nga Kuvendi i Komunës.
- III. Ngastrat kadastrale në të cilët NTP „Vëllezërit Morina“ SHPK do të aplikoj në institucionet e Republikës së Kosovës për licencim është pronë private e z. Lulzim Morina respektivisht pronarit të vetë ngastrës kadastrale **dhe është zonë e mbrojtur e përcaktuar me vendimin 01 Nr. 352/13 të datës 09.04.1986 të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit.**
- IV. Obligohen Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Inspektim që të kujdesen për implementimin e këtij vendimi konform rregullativës në fuqi.
- V. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit të tij në ueb faqen e komunës

01 Nr. 551

Rahovec, 29.02.2016

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT



-III- Nr. i prot. 551 Më 29.02 2016
Br. prot. 551 Dt. 29.02 2016
RAHOVEC - ORAHOVAC



Kryesuesi i Kuvendit

Nahit Elshani